

**URDHËR**  
**Nr. 52, datë 4.9.2026**

**PËR DELEGIMIN E PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 76 të Kushtetutës; të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 7, pika 1 të Rregullores së Kuvendit,

**URDHËROJ:**

1. Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Legjislativ dhe Monitorimit të Institucioneve në Kuvendin e Shqipërisë është autoriteti të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të institucionit, në lidhje me proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese.

2. Autoriteti i përcaktuar në pikën 1, personi që do të përfaqësojë Kuvendin, autorizohet për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin/rekursin në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative/civile/penale/gjyqimit në Gjykatën Kushtetuese.

3. Përfaqësimi i Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore/Gjykatën Kushtetuese, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në të gjitha nivelet përkatëse të gjyqimit.

4. Autorizimet për përfaqësim ligjor të Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore, kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Legjislativ dhe Monitorimit të Institucioneve në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.

5. Autorizimet për përfaqësim ligjor të Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese, kur thirret si subjekt i interesuar, lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Legjislativ dhe Monitorimit të Institucioneve në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.

6. Modeli i autorizimit për përfaqësim në proceset gjyqësore është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri.

7. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor/gjykim në Gjykatën Kushtetuese bëhet nga autoriteti i përcaktuar në pikën 1 dhe në pamundësi të tij, rast pas rasti, nga personat e përcaktuar me autorizim të lëshuar nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Legjislativ dhe Monitorimit të Institucioneve.

8. Urdhri nr. 7, datë 17.9.2025, “Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë”, shfuqizohet.

9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Niko Peleshi**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2026

LIDHJA 1

**AUTORIZIM**

**Për përfaqësimin në çështjen administrative/civile/penale  
dhe në Gjykatën Kushtetuese**

Paditës/kërkues: \_\_\_\_\_

I paditur/subjekt i interesuar: \_\_\_\_\_

Objekt: \_\_\_\_\_

Në mbështetje të neneve 64–77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile; të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të urdhrit të Kryetarit të Kuvendit nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025, “Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë”

**VENDOSA:**

Autorizimin e z./znj. \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_, për të përfaqësuar Kuvendin e Shqipërisë në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative, civile, penale, gjykim në Gjykatën Kushtetuese me objektin e sipërcituar deri në shpalljen e vendimit në gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve përkatëse/Gjykatën Kushtetuese.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM I SHËRBIMIT LEGJISLATIV  
DHE MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE**